



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 05.01.2024

Nr: 01

Ora: 10:30

VENDIM

**PËR SHQYRTIM E KËRKESËS ANKIMORE NR. 95/1, DATË 24.11.2023, DEPOZITUAR NGA
SUBJEKTI "PARTIA E LIRISË"**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 05.01.2024, me pjesëmarrjen e:

Elvin	LAKO	-	Relator
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Subjekti "Partia e Lirisë"

OBJEKT: Ankim kundër vendimit të "KQZ" rrëzimin e kërkesës së Koalicionit "Bashkë Fitojmë" për të shpallur të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të Kryetarit të Bashkisë Kuçovë, z. Kreshnik Hajdari. Ky vendim i njoftohet menjëherë Kryeministrit për të vijuar më procedurat e parashikuara nga neni 115 i Kushtetutës." Në lidhje me shqyrtimin e projektvendimit "Për shqyrtimin e

rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm, për subjektin vetëdeklarues z. Kreshnik Riza Hajdari, Kryetar i Bashkisë Kuçovë, Qarku Berat, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, datë 14 nëntor 2023, ora 12:00, të Komisionerit Shtetëror i Zgjedhjeve.

BAZË LIGJORE: Nenet 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

Rrethanat e çështjes:

1. Në bazë të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike, si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe “Kandidati/Kryetar Bashkie”.
2. Në bazë të nenit 5 të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, zoti Kreshnik Riza Hajdari, si kandidat për kryetar të Bashkisë Kuçovë, i mbështetur nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, ka depozituar në KQZ në datën 02.04.2023 formularin e vetëdeklarimit. Ky formular është regjistruar nga KQZ-ja me numër unik BR-PS-17366.
3. Me shkresën nr. 601/35 prot., datë 02.11.2023, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i De kriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin zotin Kreshnik Riza Hajdari”. Prokuroria e Përgjithshme, pas kryerjes së të gjitha verifikimeve përkatëse, i konsideron këto të fundit të plota dhe të bazuara në nenin 8, pikat 1 dhe 2, të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe në përcaktimet e pikës 3, shkronja “ç”, kreu III, dhe pikave 10, 11, 12 e 13 të kreut

V të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, ka miratuar rezultatin e verifikimit të subjektit vetëdeklarues zotit Kreshnik Riza Hajdari, sipas të cilit konstatohet si më poshtë:

- 1) Nuk rezulton të ketë gjeneralitete të tjera në përbërësit e gjendjes civile, përveç atyre të deklaruara në formular apo të ndryshme nga ato të deklaruara;
- 2) Rezulton të jetë i dënuar me vendim të formës së prerë Nr. 3286/23-6-1999, nga Gjykata e Shkallës së Parë Janinë/Gjykata Penale me një Anëtar, e cila ka vendosur:
 - a) “Në prani të të pandehurve ...14) Kreshnik Hajdari, i biri i RIZA dhe i HALIME, i lindur më 29-7-1982 në Berat, Shqipëri, punëtor (i bashkëgjykuar i mitur): Shpall fajtor secilin nga personat madhorë të përgjegjshëm penalisht dhe shkaktar secilin nga personat e mitur të përgjegjshëm penalisht (ka kryer një vepër) për shkeljet: “Hyrja në territorin grek pa ruajtur formalitetet ligjore përkatëse” (shkelje e nenit3 dhe 4 të ligjit 1975/1991).
 - b) Dënon secilin nga personat madhorë penalisht të pandehur, të shpallur fajtorë me: Katër (4) muaj burgim.
 - c) Dënon secilin nga të pandehurit e mitur të shpallur fajtorë me: Masa riedukuese e qortimit. Konverton në dënime me gjobë të gjitha dënimet me burg të vendosura tashmë më sipër të pandehurve të dënuar (të gjithë), dhe përcakton shumën e konvertimit për çdo ditë burgim në njëmijë e pesëqind (1500) dhrahmi.
 - d) Urdhëron dëbimin e menjëhershëm të të gjithë të pandehurve madhorë të huaj të dënuar me burg dhe më tej pezullon për një kohë të pacaktuar (sipas nenit 90 parag.2 të Kodit Penal) dënimin me burg të dhënë ndaj tyre, me kusht që të ekzekutohet menjëherë dëbimi i tyre tashmë i urdhëruar”.
- 3) Nuk rezulton i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- 4) Rezulton që në vitin 1999 të ketë qenë në gjykim nga Gjykata e Shkallës së Parë Janinë për: Hyrje në territorin grek pa ruajtur formalitetet ligjore përkatëse (shkelje e nenit 3 dhe 4 të ligjit 1975/1991).
- 5) Nuk rezulton të ketë qenë ndonjëherë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese për kryerjen e një vepre penale.
- 6) Nuk rezulton që ndaj tij të jetë caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale.

7) Nuk rezulton që ndaj tij të jetë lëshuar urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.

8) Nuk rezulton që ndaj tij të jetë marrë masa e dëbimit nga një shtet i huaj.

4. Në përfundim të procesit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 679, datë 4.7.2023, i ka dhënë mandatin zotit Kreshnik Hajdari si kryetar i Bashkisë Kuçovë.

5. Në seancën publike të KQZ-së të datës 14.11.2023 për vlerësimin e rezultatit të verifikimit të thelluar të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetëdeklarues, zotin Kreshnik Hajdari, tashmë kryetar i Bashkisë Kuçovë, ky i fundit nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor, zotin Theodhori Sollaku, deklaroi se nuk ekziston asnjë shkak për ndërprerjen e mandatit të zotit Hajdari si kryetar bashkie.

6. KSHZ vlerëson se për subjektin vetëdeklarues, zotin Kreshnik Hajdari, nuk ekziston ndonjë shkak, i cili sipas përcaktimeve të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” bën t’i ndërpritet mandati i kryetarit të bashkisë.

Ky ligj ka përcaktuar shkaqet/rastet kur një person ndalohet të kandidojë apo edhe të ushtrojë detyrën e kryetarit të bashkisë. Sipas këtij ligji shkaqet lidhen, krahas të tjerave, me lloj veprash penale të kryera, ose masa dënimi penal të marra në kohë të ndryshme nga subjekti vetëdeklarues.

Për zotin Hajdari nuk rezulton të ketë ndonjë vendim penal në Republikën e Shqipërisë. Për të rezulton që të ketë një vendim gjyqësor penal në shtetin grek. Sipas këtij vendimi, zoti Hajdari është fajtor për veprën penale “Kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror”, e parashikuar nga neni 298 i Kodit tonë Penal. Për këtë vepër penale atij i është dhënë si dënim “Masa riedukuese e qortimit..”.

KQZ-ja nuk ka kompetencë të vlerësojë llojin e veprës penale, llojin e sanksionit dhe të masës së dhënë ndaj një subjekti sipas një vendimi të marrë nga një organ procedural i huaj. Neni 8 i ligjit nr.138/2015 ka përcaktuar se në këtë rast është organi i prokurorisë ai që bën verifikimin e të dhënave.

7. Në përfundim të hetimit administrativ, rrethanave dhe fakteve Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me anë të vendimit nr. 816, datë 14.11.2023 *“Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues, zotin Kreshnik Riza Hajdari, kryetar i Bashkisë Kuçovë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”*, konstatoi se zoti Kreshnik Riza Hajdari, kryetar i Bashkisë Kuçovë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, nuk përfshihet në kushtet e ndalimit për të ushtruar funksionin publik të Kryetarit dhe vazhdimin e mandatit si kryetar i Bashkisë Kuçovë.
8. Subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë” ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 95 regj., datë 16.11.2023.
9. KAS-i caktoi me short z. Elvin Lako relator për shqyrtimin e kërkesës. Në mbledhjen e datës 23.11.2023, ora 11:00, pas relatimit të çështjes objekt shqyrtimi u konstatua se kërkesa ankimore nuk i plotësonte elementet e formës të parashikuara në nenin 126, pasi është paraqitur me të meta. Konkretisht ankimi duhet të depozitohet nga subjekti zgjedhor që ka interes të ligjshëm, pasi me certifikimin e rezultatit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, koalicionit i ka përfunduar personaliteti juridik.
10. Trupa e KAS vendosi kthimin e kërkesës ankimore nr. 95, datë 16.11.2023, për plotësim të elementëve të formës brenda 24 orëve nga shpallja e këtij vendimi, për shkak se afati i ankimit ndaj vendimmarrjes së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve përfundonte më datën 14.12.2023.
11. Në mbledhjen e datës 18.12.2023, u konstatua se kërkesa ankimore regjistruar me nr. 95/1, depozituar nga subjekti zgjedhor “Partia e Lirisë”, i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të Kodit Zgjedhor, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

12. Seanca e datës 05.01.2024 u zhvillua me praninë e Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së, si përfaqësues i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe të administratës së KQZ-së.
13. Gjatë seancës së shqyrtimit mori pjesë subjekti “Partia e Lirisë”, përfaqësuar nga zv. Franci Nuri dhe av. Arben Llangozi.
14. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:
 - Kërkesën ankimore nr. 95 regj., datë 16.11.2023;
 - Plotësimin e k. ankimore me nr. 95/1 datë 24.11.2023 të depozituar nga subjekti “Partia e Lirisë”;
 - Vendimin nr. 816, datë 14.11.2023 “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues, zotin Kreshnik Riza Hajdari, kryetar i Bashkisë Kuçovë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
 - Formularin e vetëdeklarimit të z. Kreshnik Riza Hajdari;
 - Rezultati i verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Kreshnik Riza Hajdari, kryetar i Bashkisë Kuçovë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

KAS-i konstaton:

1. Me vendimin nr. 816, datë 14.11.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka përmbyllur procedurën për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Kreshnik Riza Hajdari, kryetar i Bashkisë Kuçovë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë.
2. Siç rezulton nga vendimi i Komisionerit nr. 816, datë 14.11.2023, procedura e verifikimit të thelluar nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme u krye sipas kërkesës së KQZ-së (shkresa nr. 4100 prot., datë 24.4.2023), pasi Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ishte informuar nga subjekti zgjedhor,

koalicioni “Bashkë Fitojmë”, me anë të shkresës nr. 220, datë 04.04.2023, se zoti Kreshnik Hajdari rezultonte i dënuar penalisht në shtetin grek. KSHZ vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të të dhënave, të pasqyruara ose jo në formularin e vetëdeklarimit, kur ato lidhen me një juridiksion penal të huaj.

3. Nga verifikimi i thelluar (shkresa nr. 601/35 prot., datë 02.11.2023, e sektorit të dekriminalizimit në Drejtorinë e Koordinimit Institucional pranë Prokurorisë së Përgjithshme) është konfirmuar, ndër të tjera, se subjektit vetëdeklarues zotit Kreshnik Riza Hajdari rezulton të jetë i dënuar me vendim të formës së prerë Nr. 3286/23-6-1999, nga Gjykata e Shkallës së Parë Janinë/Gjykata Penale me një Anëtar “për shkeljet: “Hyrja në territorin grek pa ruajtur formalitetet ligjore përkatëse” (shkelje e nenit 3 dhe 4 të ligjit 1975/1991)”, sikurse rezulton (rrjedhimisht) “që në vitin 1999 të ketë qenë në gjykim nga Gjykata e Shkallës së Parë Janinë për: Hyrje në territorin grek pa ruajtur formalitetet ligjore përkatëse (shkelje e nenit 3 dhe 4 të ligjit 1975/1991)”.
4. Ankuesi ka ngritur pretendimin, se ky informacion zyrtar i Prokurorisë së Përgjithshme përbën shkak ligjor për ndërprerjen e menjëhershme të mandatit të kryetarit të bashkisë dhe shpalljen e pavlefshmërisë së tij, sepse pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në formularin e vetëdeklarimit passjell përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo nga funksioni publik, sikurse përcakton shkronja “ç” e pikës 3 të kreut III të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.
5. KAS-i çmon se ky pretendim ngrihet mbi analizë të gabuar të kuadrit ligjor dhe është pa bazë ligjore.
6. Neni 17 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcakton sa vijon:
 - 1) *Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.*
 - 2) *Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane.*

E drejta për t'u zgjedhur në organet përfaqësuese të shtetit shqiptar, për pasojë, edhe e drejta për të ushtruar mandatin e fituar nga zgjedhja janë të drejta themelore të individit. Ato mund të kufizohen vetëm me ligj. Kjo do të thotë se shkakun ligjor për kërkesën për ndërprerjen e mandatit të z. Kreshnik Hajdari dhe shpalljen e pavlefshmërisë së mandatit të tij, ankuesi duhet t'a kërkojë dhe gjejë vetëm tek ligji nr.138/2015 dhe jo, sikurse tenton të bëjë, tek vendimi i Kuvendit nr. 17/2016, i cili është akt nënligjor

7. Vendimi i Kuvendit nr. 17/2016 është akt nënligjor zbatues i ligjit nr. 138/2015. Dispozita e shkronjës “ç” të pikës 3 të kreut III të tij nuk mund të shërbejë si bazë ligjore për pretendimin e ankuesit edhe për shkak të faktit se ajo është dispozitë që rregullon përmbajtjen e formularit të vetëdeklarimit, por jo të drejtën për të kandiduar, zgjedhur apo ushtruar funksionet e caktuar publike. Pika 3 e kreut III të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 ka këtë përmbajtje:

“Formulari i vetëdeklarimit përmban detyrimisht një rubrikë ku pasqyrohet se:

- a) Ky formular përbën dokument zyrtar dhe i nënshtrohet publikimit;*
- b) Pasqyrimi i të dhënave të rreme në këtë formular përbën veprë penale dhe dënohet me burgim, sipas nenit 190 të Kodit Penal;*
- c) Të dhënat e pasqyruara në të i nënshtrohen një verifikimi të plotë dhe të gjithanshëm, brenda dhe jashtë Shqipërisë, nga organet shtetërore dhe Prokuroria e Përgjithshme;*
- d) Pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në të passjell përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo nga funksioni publik; d) Shtetasi subjekt verifikimi është i detyruar të japë pëlqimin e tij për verifikimin e çdo të dhëne personale, përfshirë gjurmët daktiloskopike dhe çdo të dhënë tjetër biometrike. Në rast refuzimi të dhënies së pëlqimit, shtetasi trajtohet sikur të ketë rezultuar në një nga rrethanat që përbën kusht për ndalim.*

Kjo dispozitë kërkon që në formularin e deklarimit të përfshihet një sqarim i posaçëm ligjor rreth efekteve juridike të vetëdeklarimit, por efektet juridike nuk mund të rrjedhin nga kjo dispozitë. Detyrimet e personave vetëdeklarues duhet të rrjedhin nga dispozita të përcaktuara nga ligje specifike materiale (*sipas parimit kushtetues se nuk mund të ketë kufizim pa ligj të të drejtave dhe lirive*).

8. Ankuesi nuk referoi tek dispozita ligjore që të parashikojnë “përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo nga funksioni publik”. Kodi Zgjedhor nuk e përmban një dispozitë të tillë. Po ashtu, ligji për vetëqeverisjen vendore dhe ligji i dekriminalizimit nuk përfshijnë asnjë rregullim të kësaj natyre. Për më tepër, ankuesi u përpoq të vendoste një dallim midis përmbajtjes juridike të rrethanave faktike të parashikuara nga shkronja “ç” e pikës 3 të kreut III të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit (sipas tij: kundravajtje administrative) dhe rrethanave faktike të parashikuara nga shkronja “b” e të njëjtës pikë (vepër penale).
9. Në gjykimin e KAS-it si shkronja “b” dhe shkronja “ç” kanë të njëjtën referencë ligjore, nenin 190 të Kodit Penal. Shkronja “b” paralajmëron vetëdeklaruesit për pasojën penale, shkronja “ç” paralajmëron për pasojat administrative, por të dyja u referohen të njëjtës rrethanë faktike, falsifikimit të formularit të vetëdeklarimit.
10. Vetë ankuesi e ka konsideruar faktin juridik të përshkruar në pikën 4 të konstatimeve të KAS-it si vepër penale, falsifikim i vulave, i stampave ose i formularëve, sikurse përcaktohet nga neni 190 i Kodit Penal. Në dokumentin e titulluar “Plotësim ankimi” (protokolluar në KQZ me nr. prot. 7722, datë 24.11.2023) ankuesi ka afirmuar se “duke mos deklaruar dënimin penal si më sipër shtetasi Kreshnik Hajdari ka konsumuar veprën penale të falsifikimit të formularëve, të parashikuar nga neni 190/2 i Kodit Penal”. Mbi këtë bazë, ankuesi ka vënë në lëvizje prokurorinë e posaçme për hetimin e akuzave të ngritura prej tij.
11. Faktet penale kërkojnë hetim penal, që të vërtetohen. Pa hetimin dhe gjykimin penal, çdo pretendim i shprehur nga palë të treta nuk mund të përdoret në ngarkim të personave që akuzohen publikisht, sepse kështu cenohet parimi kushtetues i prezumimit të pafajësisë. Neni 30 i Kushtetutës përcakton se “kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë”.
12. Parimi kushtetues i prezumimit të pafajësisë për akuzat penale të ngritura ndaj individit kërkon që hetimi dhe gjykimi penal t’i paraprijë çdo procedure eventuale administrative për “deklarimin e pavlefshmërisë së mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit”, sikurse përcakton shkronja “d” e pikës 1 të nenit 10 të ligjit nr. 138/2015.

13. Komisioneri, nga ana e tij, ka njohur dhe pranuar faktin juridik që i është referuar nga shkresa e Prokurorisë së Përgjithshme, por në analizën juridike me të cilën ka shoqëruar vendimin nr. 816, datë 14.11.2023 ka konkluduar de facto, se mospërputhjet, të paktën në dy pika, me formularin e vetëdeklarimit të depozituar nga subjekti vetëdeklarues Kreshnik Hajdari nuk formojnë shkelje, në kuptim të ligjit nr. 138/2015.
14. Vendimi shprehet, se “KQZ-ja vlerëson se nuk qëndron edhe pretendimi se zotit Kreshnik Hajdari duhet t’i ndërpritet mandati pasi ai nuk ka përmbushur detyrimin për deklarim të dënimit në shtetin grek”. Me këtë formulim dhe me analizën rreth tij, Komisioneri ka rrëzuar pretendimin e ankuesit për falsifikim të formularëve. Kjo analizë kapërcen kufijtë e kompetencës së Komisionerit. Komisioneri ka gjykuar dhe ka vendosur lidhur me një akuzë penale të formuluar nga ankuesi. Për këtë kompetenca i takon ekskluzivisht organit të prokurorisë dhe gjykatës kompetente penale. Ankuesi, Komisioneri apo KAS-i kanë të drejtë të formulojnë vetëm kallëzime, mbështetur në dyshime të bazuara në prova, por jo të gjykojnë rreth tyre.
15. Komisioneri u vu në dijeni gjatë shqyrtimit të praktikës, se lidhur me çështjen kishte nisur hetim penal nga ana e prokurorisë së posaçme. Rezultati i këtij hetimi ka ndikim të drejtpërdrejtë në gjykimin e pretendimit të ankuesit dhe në rezultatin e verifikimit të vetëdeklarimit. Ky fakt juridik duhet të ishte administruar dhe analizuar nga Komisioneri. Komisioneri ka pasur detyrimin që të gjykonte, nëse ishte rasti për pezullimin e shqyrtimit të çështjes, sikurse kërkon neni 66 i Kodit të Procedurave Administrative. Pika 1 e nenit 66 të KPrA përcakton se “nëse organi publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (“çështja paraprake”), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë”.
16. KAS-i çmon, se Komisioneri duhet të rishqyrtojë çështjen dhe të vendosë nëse është rasti për pezullimin e shqyrtimit, derisa gjykata të marrë vendim të formës së prerë lidhur me kallëzimin për falsifikim të formularit nga ana e subjektit vetëdeklarues

PËR KËTO ARSYE:

Data: 05.01.2024 Nr: 01
Ora: 10:30



“Për shqyrtim e kërkesës ankimore nr. 95/1,
datë 24.11.2023, depozituar nga “Partia e
Lirisë”

Bazuar në nenin 129, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin e pjesshëm të Kërkesës Ankimore nr. 95/1, datë 24.11.2023, të paraqitur subjekti “Partia e Lirisë”.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 816, datë 14.11.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm, për subjektin vetëdeklarues z. Kreshnik Riza Hajdari, Kryetar i Bashkisë Kuçovë, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
3. Kthimin e çështjes për shqyrtim tek Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve , duke lënë detyrë që të shqyrtojë faktin nëse KQZ në trajtimin e kërkesës ndodhet në kushtet e nenit 66 të Kodit të Procedurave Administrative.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Bazuar në pikën 1 të nenit 145 të Kodit Zgjedhor, kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e tij, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 152 të Kodit Zgjedhor.

U shpall sot, më datë 05.01.2024.

Elvin	LAKO	-	Relator
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar